

ARKIVI. DREJTËSIA. KUJTESA. KOHA:

Reflektime mbi ethet arkivore (*mal d'archive*) të Esat Shalës¹

VJOSA MUSLIU DHE BRUNILDA PALI

Abstrakt

Ky artikull, i cili fokusohet në “projektin” arkivor të Esat Shalës, është një reflektim mbi arkivin dhe marrëdhëniet e tij me drejtësinë, kujtesën e kohën. Prej më se njëzet vitesh, Esat Shala, një djalë i ri nga fshati Krajkovë në Kosovë, mbledh regjistrime filmike e zanore, imazhe fotografike e ditarë të masakrave dhe krimeve të luftës që ndodhën në Kosovë në vitet 1998-1999. Sot koleksioni i tij arrin në mbi 2500 artikuj, një numër me të vërtetë mbresëlënës. Vendosëm t’i përjasemi kësaj praktike nëpërmjet një analize narrative, duke u fokusuar në atë çfarë bën Shala (procesin praktik), si dhe në arsyen pse ai bën atë që bën (kuptimin që ai i vesh procesit praktik), bazuar në materialet e shkruara si dhe ato audiovizuale që ekzistojnë në rrjet mbi Shalën dhe arkivin e tij.² Jemi përpjekur që të

¹ Përkthyer në shqip nga Jonida Gashi.

² Të gjitha citimet e Esat Shalës vijnë të përkthyer në shqip nga anglishtja.

shmangim presupozimet e të mos marrim për të mirëqenë as natyrën e ndërmarrjes së Shalës dhe as motivet e tij. Përkundrazi, jemi përpjekur të angazhohemi në një “dëgjim të thellë” të përgjigjeve të tij, shpesh të përsëritura e kësisoj konsekuente.

Artikulli fillon me disa reflektime mbi arkivin dhe lidhjet e tij me luftën e të kaluarën, e, më pas, vijon me një përshkrim të kontekstit socio-politik të Kosovës së viteve 1990, në të cilin ngjizet dhe “projekti” i Esat Shalës. Nëpërmjet analizës sonë, ne e lexojmë “projektin” e Shalës si një rezistencë të patundur dhe të pandalshme, e cila i kundërvihet harresës së organizuar, si një sfidë ndaj amnezisë institucionale, si dhe një akt përkujdesje dhe drejtësie për viktimat e të mbijetuarit e luftës. Ne e lexojmë këtë përpjekje qëndrestare, pamundësinë për t’u ndalur e për t’u dorëzuar, si një formë dëshpërimi të pamposhtur, të cilin Shala e ruan me kokëfortësi.

Fjalë kyçe: Esat Shala, arkivi, drejtësia, kujtesa, lufta, koha

I. Ethet e arkivit, lufta dhe fantazmat e së kaluarës

Mal d’archive... “do të thotë kurrë të mos reshtësh, deri në pafundësi, së kërkuari arkivin...”

Jacques Derrida, *Archive Fever*

Kuptimi i fjalës arkiv vjen, në radhë të parë, nga *arkheion*-i grek: fillimisht një shtëpi, një vendbanim, një adresë, rezidenca e magjistratëve të lartë, arkonëve (*archons*), atyre që komandonin.³ Ndonëse ky kuptim i arkivit, si një vend,

³ Jacques Derrida, *Archive Fever: A Freudian Impression (Religion and*

hapësirë, godinë e koleksion dokumentesh që ruhen brenda saj, vazhdon të jetë i përhapur, ai është sfiduar me kalimin e kohës, sidomos falë punës së Michel Foucault, i cili e ka cilësuar arkivin si “ligjin e asaj çka mund të thuhet” ose “sistemin e diskursivitetit” që krijon mundësinë që ajo që thuhet të mund të thuhet.⁴ Edhe Jacques Derrida, në *Archive Fever (Ethet e Arkivit)*, e lidh arkivin dhe kontrollin mbi të me çështjen e pushtetit, kryesisht për arsyen se një nga fuqitë e arkivit është që të mvëshë (ose jo) me autoritet e legjitimitet të vërtetat e mëtuara (*truth claims*). Ata që zotërojnë regjistrimet, “ushtrojnë pushtet mbi formën dhe drejtimin e dijes historike, kujtesën kolektive dhe identitetin kombëtar, mbi mënyrën se si ne e njohim veten si individë, grupe dhe shoqëri”.⁵ Falë këtyre teorizimeve mbi arkivin, ne kemi sot një kuptim shumë më të gjerë e të politizuar të tij.⁶

Të konceptosh e të kuptosh arkivin politikisht do të thotë të shohësh me një sy kritik praktikatat e institucionalizuara të arkivimit të shteteve moderne dhe rolin e arkivistit profesionist, të ngresh pyetje mbi llojet e materialeve që ruhen dhe burimin e tyre, mbi aksesin ndaj regjistrimeve dhe rolin e arkivistit si çelësambajtësin e tyre. Kjo lloj kritike ndaj arkivave

Postmodernism), përkth. Eric Prenowitz, Chicago: University of Chicago Press, 1996.

⁴ Michel Foucault, *The Archaeology of Knowledge: And the Discourse on Language*, përkth. A.M. Sheridan Smith, New York: Pantheon, 1972.

⁵ Joan M. Schwartz dhe Terry Cook, “Archives, Records, and Power: The Making of Modern Memory”, *Archival Science* nr. 2, 2002, f. 1–19.

⁶ Marlene Manoff, “Theories of the Archive from Across the Disciplines”, *Libraries and the Academy* nr. 1, 2004, f. 9–25; Leswin Laubscher, “Facing the Apartheid Archive, or, of Archons and Researchers”, *South African Journal of Psychology* vëll. 40, nr. 4, 2010, f. 370–381.

institucionale ka bërë që fokusi të kthehet te krijimi dhe të përvetësimi i arkivave, historisë dhe kujtesës nga ana e kolektivave dhe lëvizjeve aktiviste “nga poshtë” (*grassroots*), gjë që ka çuar gradualisht në shfaqjen e “kundër-arkivave”. Duke kolektivizuar dhe pluralizuar prodhimin e dijes arkivore, “kundër-arkivat” kanë radikalizuar politikën e arkivit, duke e kthyer atë në një mjet rezistence.⁷

Megjithatë, kërkimet dhe literatura mbi arkivin, qoftë ky i institucionalizuar ose një “kundër-arkiv”, tregojnë se, në thelb, arkivi nuk është as mbartësi e as autoriteti përfundimtar mbi të vërtetat e përjetshme. Përkundrazi, arkivi përshfaqet si një hapësirë kontestimi,⁸ sidomos sa i përket ekzistencës së “një sërë praktikash, shfrytëzimesh e përdorimesh strategjike të dijeve arkivore në hapësirat sociale e politike”, që kanë për synim prodhimin e dijes dhe përvetësimin e autoritetit dhe kredibilitetit.⁹

Ndonëse debatet mbi arkivat, si hapësira kontestimi, janë të dobishme e me vlerë në të gjitha shoqëritë, të cilat kanë përjetuar ndryshime sociale të qenësishme (si p.sh. në kontekstet postkomuniste e ato postkoloniale),¹⁰ arkivat luajnë

⁷ Susan Pell, “Radicalizing the Politics of the Archive: An Ethnographic Reading of an Activist Archive”, *ARCHIVARIA* nr. 80, 2015, f. 33–57.

⁸ Mary Kandiuk, red., *Archives and Special Collections as Sites of Contestation*, Sacramento, California: Library Juice Press, 2020.

⁹ Pell, “Radicalizing the Politics of the Archive: An Ethnographic Reading of an Activist Archive”, f. 46.

¹⁰ Ann Laura Stoler, *Along the Archival Grain: Epistemic Anxieties and Colonial Common Sense*, Princeton: Princeton University Press, 2009; Saygun Gökarıksel, “Beyond Transparency: The Communist-Era Secret Police Archives in Postsocialist Eastern Europe”, *Archives and Records* vëll. 41, nr. 3, 2020, f. 236–253.

një rol veçanërisht të rëndësishëm në diskutimet mbi drejtësinë, të vërtetën e kujtesën në përfundim të konflikteve të armatosura.¹¹ “Lufta lë pas jo vetëm fitues e humbës, kufij të rinj politik, heronj e të përbuzur, të vdekur e të gjymtuar”, ajo, gjithashtu, hap punë për të gjithë ata që duan të kujtojnë (ose të harrojnë), teksa rreken të gjejnë kuptimin e diçkaje, në dukje të pakuptimshme.¹² Kësisoj, pas (dhe gjatë) luftës, arkivat mund të mobilizohen, si për qëllime represioni ashtu dhe për të arritur drejtësinë në procese nga më të ndryshmet, si vendimet e gjykatave, verdikte historike dhe praktikat përkujtimore.¹³

Për shkak të peshës që ata kanë, gjatë luftës arkivat mund të shkatërrohen ose të mbrohen me vetë jetën.¹⁴ Ata që mbledhin ose mbrojnë dokumentime arkivore të luftës, shtyhen shpeshherë nga dëshira për të vënë në vend një padrejtësi, për të

¹¹ Eric Ketelaar, “Archives as Spaces of Memory”, *Journal of the Society of Archivists* vëll. 29, nr. 1, 2008, f. 9–27; Richard Harvey Brown dhe Beth Davis-Brown, “The Making of Memory: The Politics of Archives, Libraries and Museums in the Construction of National Consciousness”, *History of the Human Sciences* vëll. 11, nr. 4, 1998, f. 17–32.

¹² Richard Cox, “Archives, War, and Memory: Building a Framework”, *Library & Archival Security* vëll. 25, nr. 1, 2012, f. 21–57 (f. 22).

¹³ Natalia Bermúdez Qvortrup, “Documenting the Armenian Genocide in Norway: The role of a National Archive in the social life of a collection”, *Archives and Records*, 2020, DOI: 10.1080/23257962.2020.1813094; Michelle Caswell, *Archiving the Unspeakable: Silence, Memory, and the Photographic Record in Cambodia*, Madison, Wisconsin: University of Wisconsin Press, 2014; Tom A. Adami dhe Martha Hunt, “Genocidal Archives: The African Context—Genocide in Rwanda”, *Journal of the Society of Archivists* vëll. 26, nr. 1, 2005, f. 105–121.

¹⁴ Hariz Halilovich, “Reclaiming Erased Lives: Archives, Records and Memories in Post-War Bosnia and the Bosnian Diaspora”, *Archival Science* nr. 14, 2014, f. 231–247; Anne J. Gilliland, “To What Lengths the ‘Physical and Moral Defence of the Record’ in Times of Conflict and Exigency?”, *Archives and Records* vëll. 39, nr. 2, 2018, f. 117–138.

gjetur fajtorët e për të rindërtuar jetët e tyre e të komunitetit ku bëjnë pjesë. Por, në kushtet e luftës, një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit përfundon, qëllimisht ose jo, që shkatërrohet. Ndosht që, në përfundim të luftës, të kenë mbetur shumë pak regjistrime, që gjenden mes agresorëve ose mes të të mbijetuarve të luftës dhe komunitetet e tyre. Për nga vetë natyra e tyre, mizoritë i bëjnë njerëzit që të duan t'i injorojnë, groposin ose mohojnë.¹⁵ Kombet ngrihen mbi harresën dhe amnezinë, mbi fshirjen e trashëgimive, mbi një proces të administruar dhe të organizuar harrese. Rrjedhimisht, “arkivi është i kapur në dialektikën e pashmangshme mes mbishkrimit/shkatërrimit. Në shtysën për të arkivuar (për të mbledhur, për të dorëzuar) është gjithmonë i përfshirë një lloj shkatërrimi; shkatërrimi dhe harresa janë kësisoj në zemër të çdo ndërmarrjeje arkivore. Thënë thjesht, njeriu arkivon pasi ai i trembet humbjes.”¹⁶

Në *Spectres of Marx (Përhijimet e Marksit)*, Derrida argumenton se zotësia jonë për të qëndruar në bashkëbisedim dhe “për të mësuar të bashkëjetojmë me fantazmat”, përhijimet e së kaluarës, sidomos me fantazmat e viktimave të mizorive, përbën kushtin themelor për rikonceptimin e së kaluarës dhe ndërtimin e një të ardhmeje të drejtë.¹⁷ Përhijimi përvijon atë që i fanitet e që i rikthehet një shoqërie, kur “fantazmat” kanë punë të pambaruara, diçka që duhet ndrequr, një padrejtësi që duhet

¹⁵ Aida Alayarian, *Consequences of Denial: The Armenian Genocide*, Londër: Taylor & Francis Group, 2008.

¹⁶ Marie-Aude Baronian, “Image, Displacement, Prosthesis: Reflections on Making Visual Archives of the Armenian Genocide”, *Photographies* vëll. 3, nr. 2, 2010, f. 205-223 (f. 206).

¹⁷ Jacques Derrida, *Specters of Marx: The State of the Debt, The Work of Mourning, and the New International*, përkth. Peggy Kamuf, Londër: Routledge, 1994.

vënë në vend. Përhijimi dhe fanitja shënojnë fushëveprimin e asaj që nuk jeton më, ose që ende nuk jeton, që nuk është diçka e pranishme ose jo, por diçka që potencialisht është e kudondodhur, duke ripërvetësuar kësisoj të pathënën e të shpërfillurën.¹⁸

Ndonëse nuk kanë munguar diskutimet rreth arkivave personalë, konceptuar si një praktikë kulturore, që sjell një kënaqësi të posaçme ose si politikë e jetës së përditshme,¹⁹ pak është thënë mbi arkivat personalë dhe jointitucionalë, që janë të rëndë për t'u mbajtur mbi supe dhe pështjelluese, që e lënë njeriun pa gjumë, siç është arkivi i Esat Shalës. Çfarë e shtyn njeriun të koleksionojë të dhëna pështjelluese? Cila është vlera e këtyre të dhënave? Kush duhet ta mbajë përgjegjësinë për një koleksion të tillë? Ku dhe si do të depozitohet e ruhet materiali? Cila është kostoja psikosomatike që mund të ketë kjo mbi dëshmitarët okularë të ngjarjeve të dokumentuara? Këto janë disa nga pyetjet²⁰ që shtrajmë më poshtë.

¹⁸ Michalinos Zembylas, "Pedagogies of Hauntology in History Education: Learning to Live with the Ghosts of Disappeared Victims of War and Dictatorship", *Educational Theory* vëll. 63, nr. 1, 2013, f. 69-86.

¹⁹ Catherine Hobbs, "The Character of Personal Archives: Reflections on the Value of Records of Individuals", *Archivaria* nr. 52, 2001, f. 126-135; Sue McKemmish, "Evidence of Me", *Archives and Manuscripts* nr. 24, 1996, f. 28-45; Fiona Cosson, "The Small Politics of Everyday Life: Local History Society Archives and The Production of Public Histories", *Archives and Records* vëll. 38, nr. 1, 2017, f. 45-60.

²⁰ Disa prej këtyre pyetjeve janë frymëzuar nga Helen Forde. Shiko: Helen Forde, "We Must Remember Our Past So That We Do Not Repeat It", *Journal of the Society of Archivists* vëll. 25, nr. 2, 2004, f. 117-122.

II. Kosova: Arkivi si rezistencë

Në vitin 1999, ushtria serbe kishte hyrë në një luftë gjithëpërfshirëse kundër shqiptarëve të Kosovës. Përgjatë konfliktit të armatosur, i cili zgjati më pak se dy vjet, humbën jetën më shumë se 12,000 civilë, ndërsa rreth 850,000 të tjerë u zhvendosën forcërisht.²¹ Ndonëse kanë kaluar 23 vjet nga përfundimi i luftës, në një fshat në thellësi të Kosovës, lufta, kujtesa e saj dhe vendosmëria për ta mbajtur kujtesën gjallë, sfidojnë konceptin e kohës. Në shtëpinë e tij, në fshatin Krajkovë, afër Drenasit, 36-vjeçari Esat Shala, i cili vuan nga çrregullime të gjumit dhe dridhje të trupit, i kalon netët duke parë regjistrime të luftës në Kosovë. Shala thotë se ai sheh “jo vetëm materialet e reja që gjej [...] nuk rri dot pa parë as ato që kam gjetur më herët. Pastaj nuk arrij të jem i qetë.”²² Ndonëse në pamje të parë, një investim i tillë libidinal, kaq i përqendruar e gjithëpërfshirës, në një arkiv luftime, i cili, për më tepër, rezulton në simptoma traumatike e psikosomatike, mund të duket i pakuptueshëm, ai pasqyron, në fakt, një qëndrim e zotim thellësisht etik për nga natyra.

Shala filloi të shihte videoregjistrime të luftës në Kosovë në internet në mesin e viteve 2000. Ajo çka nisi në adoleshencë si një formë “terapije” për të përballuar efektet e pagjumësisë kronike në dhomën e tij të gjumit, u shndërrua në një strukturë

²¹ Human Rights Watch, “Under Orders: War Crimes in Kosovo”, 26 tetor 2001: <https://www.hrw.org/report/2001/10/26/under-orders/war-crimes-kosovo> [referuar më 15 janar 2022].

²² Esat Shala, cituar në Serbeze Haxhiaj, “Kosovo War Video Collector Seeks to Preserve Evidence of Crimes”, *Balkan Insight*, 13 maj 2021.

të mirëfilltë arkivore. Fillimisht, veprimtaria koleksionuese e Shalës u përqendrua në materialet që gjendeshin në YouTube dhe platforma të ngjashme në rrjet. Me shterjen e sferës virtuale, Shala e zgjeroi koleksionin e tij me pamje dhe videoregjistrime që vinin nga individë privatë, qytetarë të Kosovës, operatorë profesionistë, gazetarë lufte etj. Deri më sot, ai ka grumbulluar një sasi prej 2500 videokasetash VHS me materiale lufte, që janë pjesë e arkivit të tij personal. Videot përfshijnë xhirime amatore të dëshmitarëve okularë ose të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), si dhe xhirime të ekipeve televizive. Kasetat u prodhuan gjatë ose menjëherë pas kryerjes së masakrave që dokumentojnë. Për më tepër, Shala zotëron regjistrime zanore, imazhe fotografike dhe ditarë të masakrave.²³

Duke folur për mediet kosovare, Shala është shprehur se marrja e materialeve nga individët privatë ka qenë një sipërmarrje e vështirë. Shumëkush ka vënë në pyetje qëllimet e tij, duke nënvijëzuar absurditetin e veprimeve të tij. “Ka pasur raste që kam fjetë në oborret e njerëzve, për t’i bindë që t’me jepnin inçizimet”, tregon Shala në një intervistë me Klan Kosovën.²⁴ Ka pasur dhe nga ata që i kanë kërkuar shpërblim monetar në këmbim të materialit që zotëronin. “Ata që janë përpjekë të më shesin xhirimet e tyre janë kriminelë më të mëdhenj se ata që i vranë njerëzit gjatë luftës”, ka thënë Shala gjatë së njëjtës intervistë. Edhe atij vetë nuk i kanë munguar propozime të tilla, diçka që Shalës i duket tejet shokuese dhe

²³ Po aty.

²⁴ “Esat Shala, koleksionues i videove nga lufta e vitit 1998-99”, Klan Kosova, 29 mars 2021.

ofenduese: “Më kanë kërkuar t’i shes inçizimet, po s’kam pranuar se gjaku nuk shitet.”²⁵

Materialet e mbledhura, pjesa dërrmuese në formatin VHS, ruhen në dhomën e tij të gjumit. Ndonëse nuk ka kurrfarë trajnimit si arkivist, gjatë pesë viteve të fundit Shala ka filluar të konvertojë një pjesë të materialeve në format digjital. Ai tregon se, ndërsa puna e tij filloi të njihej jashtë Kosovës, pjesëtarë të diasporës kosovare janë ofruar t’i blejnë pajisjet që i duhen për digjitalizimin e materialeve. Ai i ruan, inventarizon e arkivon pjesën tjetër të kasetave VHS në sirtarët e dollapët e dhomës së tij. “I ruaj këto materiale me jetë, ashtu siç ruhet dhe mbrohet jeta gjatë luftës”, ka shpjeguar Shala në një intervistë për *Insajderin* në 2021,²⁶ duke shtuar se fle “me frikën se çfarë do t’u ndodhë këtyre regjistrimeve, nëse shtëpia digjet ose dëmtohet”. Ai tregon se rrallëherë largohet nga shtëpia, pa u siguruar më parë që regjistrimet janë në duar të sigurta. Duke qenë se ato janë me rëndësi për shtetin e Kosovës, pasi mund të dëmtojnë shtetin serb, kur Shala nuk ndodhet në shtëpi janë zakonisht nëna ose bashkëshortja e tij që kujdesen për regjistrimet. Me përjashtimin e tyre, ai nuk lejon asnjë pjesëtar tjetër të familjes që t’i shohë imazhet, madje, dhe të hyjë në dhomën e tij. Megjithatë, Shala nuk është thjesht kujdestari i këtyre materialeve. Ai duket se jeton me dhe nëpërmjet këtyre regjistrimeve. Shala konstaton se e ka parë çdo regjistrim pesë deri në dhjetë herë; sikur të donte të sigurohej se i ka mbijetuar imazheve që i kanë kaluar para syve. Ai ishte vetëm

²⁵ “Esat Shala ruan mbi 2 mijë video incizime të krimeve të luftës në Kosovë”, *Kallxo*, 17 gusht 2021.

²⁶ “Esat Shala: Kam probleme me gjumin pasi i shoh pamjet e masakrave në Kosovë”, *Insajderi*, 28 maj 2021.

gjashtëmbëdhjetë vjeç kur filloi t'i mblidhte këto materiale dhe, pavarësisht impaktit që imazhet e rënda patën mbi gjumin e tij, Shala thotë se ka vazhduar dhe vazhdon t'i shohë ato, pasi kërkon të familjarizohet me humbjen e të kuptojë dhimbjen e viktimave dhe të të mbijetuarve.²⁷ Ndërkaq, mbi dyzet për qind e xhirimeve nuk janë publikuar ndonjëherë. Orvatjet e tij për t'i publikuar videot në Facebook kanë rezultuar të pasuksesshme, më së shumti kjo për shkak të politikave të Facebook-ut në lidhje me materialet, përmbajtja e të cilave është e një ndjeshmërie të lartë. Jo vetëm kaq, Shala thotë se ia bllokojnë llogarinë në Facebook pesë deri në gjashtë muaj në vit, pasi përmbajtja e xhirimeve që ka mbledhur shkel rregullat e tyre.²⁸

Që kur ka filluar të shikojë e të mbledhë materiale videografike, Shala ka kërkuar xhirime të familjes së tij dhe të vetvetes. Gjatë luftës, Shala ishte vetëm dymbëdhjetë vjeç. Fshati ku ai banonte u bombardua tri herë. Familja e tij arriti t'i mbijetonte dy sulmeve të para. Gjatë bombardimit të tretë, i cili ndodhi ende pa gdhirë, ushtria serbe grumbulloi civilët e mbijetuar në ambientet e një shkolle. Duke folur për median kosovare, Shala ka treguar sesi, pasi hynë brenda godinës, ushtria serbe i ndau meshkujt nga femrat, dhe se më shumë se dyqind persona, që u morën peng nga forcat serbe atë ditë, nuk janë gjetur ende sot e kësaj dite. Një nga dyqind njerëzit e zhdukur atë ditë në vitin 1998 është xhaxhai i Shalës. Së bashku me familjen e tij, ai i kishte kaluar tre muajt e fundit në Malin e

²⁷ Esat Shala në intervistë me Arsim Lanin, *Frontal*, T7, 19 maj 2021.

²⁸ “Esat Shala, grumbullues i dëshmimeve të krimeve të luftës së fundit në Kosovë – Kujdes pamje të rënda”, Kanal 10, 14 maj 2021.

Berishës. “Mbaj mend gjithçka nga lufta”, thotë Shala.²⁹ Në përfundim të luftës në vitin 1999, numri i personave të zhdukur arrinte 4500 vetë sipas Komisionit mbi Njerëzit e Humbur (Comission on Missing Persons), gjurmët e 1700 prej të cilëve nuk janë gjetur deri më sot. Ndërkaq, gjatë dy dekadave të fundit, në territorin e Serbisë janë zbuluar një sërë varresh masive, ku janë gjetur eshtrat e shumë njerëzve të humbur, çka dëshmon se civilë shqiptarë janë transportuar dhe varrosur në varre masive në këtë territor.³⁰

Para se të fillonte lufta në Kosovë, gjatë viteve 1980, i ati dhe xhaxhai i Shalës kishin qenë të burgosur politikë. Kjo është periudha që pasoi klimën progresiste, por jetëshkurtër të Jugosllavisë së viteve 1970, kur çarjet etnike (*ethnic cleavages*) mes serbëve dhe shqiptarëve filluan të rishfaqeshin. Kushëriri i parë i Shalës u vra gjatë demonstratave të fundviteve 1990, kur ishte vetëm 24 vjeç. Me fillimin e luftës, dy motra dhe dy vëllezër të Shalës u futën në radhët e UÇK-së. “Askush nuk flet për ata, apo për çfarë na ndodhi të gjithëve ne, dhe kjo pasi kur harruam u shndërruam në kriminelë”, është shprehur Shala në një tjetër intervistë.³¹ Motra e tij njëzetvjeçare, Luljeta, dhe i fejuari i saj u vranë nga forcat serbe në kufirin midis Kosovës dhe Shqipërisë, së bashku me 40 anëtarë të tjerë të UÇK-së. Ata kishin vajtur në Shqipëri për të marrë armë për luftën e tyre guerile. Shala ka arritur të gjejë një xhirim të momentit të ekzekutimit të motrës së tij, ku, siç tregon, ajo qe e vetmja e cila

²⁹ “Esat Shala ruan mbi 2 mijë video incizime të krimeve të luftës në Kosovë”, *Kallxo*, 17 gusht 2021.

³⁰ “Serbia unearths mass grave from Kosovo war”, Reuters, 3 dhjetor 2020.

³¹ “Esat Shala ruan mbi 2 mijë video incizime të krimeve të luftës në Kosovë”, *Kallxo*, 17 gusht 2021.

refuzoi të dorëzohet.

Fenomeni i arkivave joinstitucionalë nuk është i padëgjuar në Kosovën e paraluftës. Në vitin 1987, Slobodan Milošević u bë President i Serbisë dhe u deshën vetëm dy vjet që Kosova të humbiste statusin autonom, të cilin e kishte gëzuar deri atëherë. Fill pas kësaj, shqiptarët e punësuar në sektorin publik u larguan nga vendet e tyre të punës, shkollat dhe universitetet në gjuhën shqipe u mbyllën, dhe e njëjta gjë ndodhi dhe me sektorët e medias e të kulturës. Për rreth një dekadë, mes viteve 1990 e 1999, shqiptarët e Kosovës u vetorganizuan si dhe organizuan shërbimet e tyre publike me anë të një sistemi paralel. Dëshmi dhe prova të akteve të rezistencës ndaj qeverisë serbe, duke përfshirë grevën e minatorëve në Mitrovicë, në vitin 1989, protestat studentore të mesit të viteve 1990, si dhe dhunimin sistematik të të drejtave të njeriut përgjatë viteve 1990, u mblodhën e u arkivuan nga individë privatë, krahas organizatave të caktuara, ndër të tjera, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (Council for the Defence of Human Rights and Freedoms) dhe Motrat Qiriazit.³² Këto iniciativa individuale të mbledhjes së të dhënave mund të interpretohen në mënyrë të dyfishtë: si akte evidencimi, por edhe si akte rezistence.

Një rast tipik është ai i Emin Miftarit (71), një mësues kimie nga fshati Bresalc në Gjilan. Pranverën e vitit 1990,

³² Për më shumë informacion shiko: Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, Londër: Pluto Press, 2000; Vjosa Musliu, *Europeanisation and Statebuilding as Everyday Practices: Performing Europe in the Western Balkans*, Londër: Routledge, 2021; Besa Shahini, "Lessons in Resistance: Kosovo's Parallel Education System in the 1990s", *Prishtina Insight*, 14 tetor 2016.

brenda një periudhe dyjavore, afërsisht 7000 nxënës të shkollës së mesme, rreth e përqark Kosovës, shfaqën simptoma helmimi,³³ një situatë e cila iu raportua autoriteteve qendrore jugosllave nga ekipe të ndryshme mjekësh. Qëndrimi zyrtar i qeverisë së Beogradit qe se të dhënat ekzistuese nuk mjaftonin për të ngritur një padi helmimi, dhe se e gjitha ishte një mashtrim i kurdisur nga “separatistët shqiptarë”. Kjo rezultoi në burgosjen e dhjetëra mjekëve shqiptarë, që gjoja kishin thyer betimin e mjekut. Miftari i shoqëroi personalisht nxënësit e tij në klinikën mjekësore, dhe me një kamera dore filloi të dokumentonte rastet që pa atje. Ashtu si Shala, ai nuk u mjaftua vetëm me materialet që kishte xhiruar vetë, por filloi të mblidhte edhe materiale të ngjashme, që i kishin xhiruar individë të tjerë privatë, materiale që i ruajti në shtëpinë e tij si prova që kundërshtonin versionin zyrtar të qeverisë jugosllave të kohës rreth ndodhive në fjalë.

III. Kujtesa si detyrim, drejtësia që do të vijë

*Njerëzit ndryshojnë, dhe buzëqeshin: po heka mbetet.
Shpartalluesja kohë është mbrojtësja kohë.³⁴*

T. S. Eliot, *Katër Kuartete*

Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999, Kosova u shndërrua në subjekt të paketës së strukturave dhe institucioneve që përfaqësojnë intervencionizmin liberal dhe shtetndërtimin ndërkombëtar. Organizata e Kombeve të

³³ Shiko: <https://www.youtube.com/watch?v=4GgvO8dUNHA> [referuar më 10 shkurt 2022].

³⁴ Vargjet janë përkthyer nga Ataol Kaso.

Bashkuara, Bashkimi Europian dhe NATO-ja dërguan misione të njëpasnjëshme që synonin “ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit” në vend, që, përgjithësisht, kuptohej si mungesa e përplasjeve të armatosura ndëretnike. Krahas Bankës Botërore, FMN-së, OSBE-së dhe agjencive të tjera Perëndimore, këto institucione filluan të ndërtojnë në Kosovë një shtet shumë-etnik, i cili bazohej në “standardet më të larta ndërkombëtare dhe evropiane” të sundimit të rendit ligjor, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.³⁵ Ndërkaq, çështjet dhe proceset që lidheshin me drejtësinë tranzicionale iu deleguan Gjykatës Ndërkombëtare Kriminale për ish-Jugosllavinë në Hagë, ku, mes viteve 1993 dhe 2017, u gjykuan një sërë zyrtarësh të lartë politikë dhe ushtarakë.³⁶ Por ka diçka paradoksale në këtë mes, duke qenë se projekti ndërkombëtar shtetndërtues që u shpалos në Kosovën e pasluftës, karakterizohej, më së shumti, nga tendenca për të mos u marrë me krimet, traumën dhe ngjarjet e luftës. “Të mos merremi me të kaluarën, por t’i mbajmë sytë nga e ardhmja demokratike” u shndërrua në parullën e strukturave ndërkombëtare, parullë që e përqaftuan edhe qeveritë e njëpasnjëshme kosovare, të cilat përbëheshin kryesisht nga ish-luftëtarë të UÇK-së. Kjo heshtje – në mos harresë – e organizuar, sugjeron se kujtesa aktive e luftës, kuptuar si një veprimtari e organizuar për depozitimin dhe mbrojtjen sistematike të dëshmive dhe provave të periudhës së luftës, si dhe mëtimet rreth çdo forme drejtësie dhe/ose dëmshpërblimi,

³⁵ Vjosa Musliu, “Multi-Ethnic Democracy as an Autoimmune Practice: The Case of International Mission in Kosovo”, *British Journal of Politics and International Relations* vëll. 19, nr. 1, 2017, f. 188-201.

³⁶ Aidan Hehir dhe Furtuna Sheremeti, red, *Kosovo and Transitional Justice: The Pursuit of Justice After Large-Scale Conflict*, Londër: Routledge, 2021.

mund të interpretohen si akte provokimi e, madje, hakmarrjeje karshi serbëve, çka do të minonte imazhin e projektuar të Kosovës si një shtet shumë etnik.

Në këtë plejadë, projekti arkivues i Shalës mund të lexohet si një akt rezistence kundrejt një heshtjeje të organizuar; si një akt mosbindjeje kundrejt një harrese institucionale; e, gjithashtu, si një akt drejtësie për viktimat dhe të mbijetuarit e luftës. Nocioni që ai ka për drejtësinë përkon herë me forma morale e ligjore dëmshpërblimi, dhe herë me idenë e dinjitetit. Aspektin e rezistencës në narrativën e Shalës e vërejmë në alarmimin e tij në lidhje me mungesën dhe përfundimisht humbjen e dëshmimeve dhe provave të luftës. Fakti që këto nuk janë ruajtur, sidomos kur ishin të përdorshme dhe të prekshme, e që nuk është kërkuar ndonjëherë drejtësia për çka rrëfehët në to, janë të pakuptueshme për Shalën. “Nëse dikush vjen në Kosovë dhe do me ditë se çfarë ka ndodhë gjatë luftës, çfarë t’iu tregojmë? S’kemi çfarë t’iu tregojmë dhe të vërtetojmë”, ka thënë Shala në një intervistë për një kanal televiziv lokal.³⁷ Në fakt, kur udhëton nëpër Kosovë, është i pashmangshëm ballafaqimi me një sërë statujash prej bronzi të përmasave gati komike, që përkujtojnë luftëtarë të UÇK-së. Pjesa dërrmuese e këtyre statujave janë kritikuar mbi baza estetike. Të tjerë kanë vënë në dukje se gjithëprania e statujave mashkullore që përkujtojnë luftëtarët e lirisë, të veshur me uniformë ushtarake e me kallashnikov në dorë, rrezikon ta shndërrojë luftën e Kosovës si dhe kujtesën e saj në një betejë e fitore të patriarkatit

³⁷ “Esat Shala, grumbullues i dëshmimeve të krimeve të luftës së fundit në Kosovë – Kujdes pamje të rënda”, Kanal 10, 14 maj 2021.

dhe burrërisë.³⁸ Në të njëjtën kohë, nuk ekziston asnjë muze apo hapësirë e përbashkët përkujtimi për viktimat e luftës në Kosovë, si, për shembull, për fëmijët e vrarë gjatë luftës. Gjithashtu, nuk ekziston një hapësirë e ngjashme as për rezistencën e viteve 1980 e 1990 me dëshmitë e të dhënat përkatëse. Shtëpia e familjes Jashari në Prekaz, që mbahet si një simbol i luftës së Kosovës, ende nuk është restauruar siç duhet. Vetëm në vitin 2015, në saj të indinjatës e revoltës së publikut në fillim të viteve 2010, u ngrit në Prishtinë një statujë që përkujtonte 20.000 gratë e përdhunuara gjatë luftës, e cila mban emrin *Heroinat*.

Shalën nuk duket se e habit mungesa e interesit mbi këtë çështje nga ana e strukturave dhe institucioneve ndërkombëtare në Kosovë. Madje, në narrativën e tij, ai i përjashton plotësisht strukturat ndërkombëtare nga çdo lloj bashkëfajësie a përgjegjësie në lidhje me këtë çështje. Në të njëjtën kohë, në narrativën e tij dallohet një lloj *shoku* dhe *habie* sa i përket rolit mospërfillës të autoriteteve kosovare. Duke folur për *Insajderin*, Shala është shprehur se: “Elita politike kosovare e pasluftës duket se nuk është në dijeni që ka pasur një luftë në Kosovë”, duke theksuar faktin dhe, në të njëjtën kohë, paradoksin se qeveritë e periudhës së pasluftës përbëheshin nga ish-luftëtarë guerilas. “Institucionet e Kosovës kanë dështu në hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës. Kjo më shtyu të merrem me këtë punë”, shtoi ai. Në një tjetër intervistë, kësaj radhe për

³⁸ Nita Luci dhe Linda Gusia, “Inside-Out and Outside-In on Dealing with the Past in Kosovo”, në *Unravelling Liberal Interventionism: Local Critiques of Statebuilding in Kosovo*, Londër: Routledge, 2019; Nita Luci, *Seeking Independence: Making Nation, Memory, and Manhood in Kosova*, tezë doktorale: University of Michigan, ShBA, 2014.

Klan Kosovën, Shala është shprehur se, në kontekstin e kësaj heshtjeje, duke qenë se institucionet publike nuk kishin interes “u desh një njeri si puna ime, krejt nga periferia, për të bë punën e shtetit”. “Sa ma shumë që i shikoj këto masakra, aq më shumë e urrej politikën e Kosovës, udhëheqësinë e Kosovës...”, tha ai në përfundim. *Shoku* dhe *habia* e tij nuk kufizohen vetëm me shtresën qeverisëse, ndonëse ai pohon se i sheh këta të fundit si përgjegjësit kryesorë. “Nuk e kuptoj përse televizionet tona nuk janë të interesuara t’i shfaqin këto pamje që nuk janë shfaqur ndonjëherë më parë dhe që qartësisht tregojnë se kush bëri çfarë”, ka thënë ai në një intervistë³⁹, ndërsa në një tjetër⁴⁰ duket i habitur që videot e tij në YouTube, të cilat dokumentojnë krime rrëqethëse, nuk kanë arritur të shikohen me miliona herë. Kur flet për grumbullimin dhe arkivimin e dëshmimeve dhe provave, ai i referohet një *detyrimi*, i cili është universal dhe që duhej të kishte qenë preokupimi i të gjithë atyre që vuajtën gjatë luftës. Në kuadrin e kësaj narrative, përjetimi i luftës, humbjes dhe traumës nuk mund të konceptohen pa *detyrimin* për t’i dokumentuar e faktuar ato ashtu siç duhet. Shala argumenton se, për shkak të inercisë së shtetit kosovar për të mbledhur prova dhe dëshmi, janë serbët ata që e kontrollojnë narrativën mbi luftën e Kosovës, të cilët kanë mobilizuar energji e burime të konsiderueshme për të përfituar sa më shumë nga ngjarje të caktuara dhe interpretimi i tyre, gjë që i ka ndihmuar që të inkuadrohen jo si agresorë, por si viktimë të luftës.

Në vitin 2021, Kosova përjetoi një “ndryshim

³⁹ “Esat Shala, koleksionues i videove nga lufta e vitit 1998-99”, Klan Kosova, 29 mars 2021.

⁴⁰ “Esat Shala, grumbullues i dëshmimeve të krimeve të luftës së fundit në Kosovë – Kujdes pamje të rënda”, Kanal 10, 14 maj 2021.

regjimesh”, kur partia e majtë nacionaliste, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), erdhi në pushtet me një shumicë të paprecedentë, duke i dhënë fund qeverisjes njëzet-vjeçare të partive politike, që dominoheshin nga ish-luftëtarë të UÇK-së. Drejtuesi i LVV-së, Albin Kurti, mbajti një qëndrim të qartë, sa i përket reciprocitetit mes shtetit kosovar dhe atij serb në arenën politike, si dhe mbi krijimin e mekanizmave dhe nisjen e procedurave ligjore për një ballafaqim me Serbinë për krimet e saj ndaj shqiptarëve të Kosovës. Pak kohë pasi erdhi në pushtet, qeveria shpalli planet për ngritjen e një Instituti Kërkimor për Krimet e Luftës, i pari institucion i këtij lloji në Kosovë, ndërsa pranverën e vitit 2021 qeveria Kurti njoftoi se ishte duke ngritur një padi kundër Serbisë për gjenocid në Kosovë. Instituti Kërkimor për Krimet e Luftës u hap për herë të parë në vitin 2011 dhe kishte për qëllim mbledhjen dhe inventarizimin e informacionit mbi krimet e kryera në Kosovë gjatë luftës (1998-1999). Ai u mbyll zyrtarisht në vitin 2018 me akuzën se nuk kishte arritur të përmbushte misionin e tij. Ndërkaq, ministri aktual i Drejtësisë në Kosovë, Albulena Haxhiu, është takuar me Esat Shalën për t’u informuar rreth materialit arkivor që ai ka mbledhur ndër vite e që mund të përdoret, si për Institutin Kërkimor për Krimet e Luftës, ashtu dhe për padinë e gjenocidit. Shala e sheh këtë si fillimin e një procesi tejet të vonuar drejtësie. E, megjithatë, ai do të vazhdojë me veprimtarinë e tij arkivore. “Do të ndaloj vetëm kur të kem gjetur provën e fundit; kur të shoh Institutin e Krimeve të Luftës të hapur dhe kur ne [Kosova] të kemi paditur Serbinë për krimet që ka kryer”⁴¹, ka thënë ai.

⁴¹ “Esat Shala ruan mbi 2 mijë video incizime të krimeve të luftës në

IV. Barra e turpit, koha që kalon dhe kujdesi për të vdekurit

Duke dhënë gjithë kohën tonë, ne japim gjithçka ose të gjithën, nëse gjithçka ne japim është në kohë dhe ne japim gjithë kohën tonë.

Jacques Derrida, *Given Time*

Në librin e saj *Onnot Being Able to Sleep (Mbi pamundësinë për të fjetur)*, Jacqueline Rose zhbiron shkaqet që na lënë netëve pa gjumë, duke identifikuar turpin si një emocion, i cili lidhet në mënyrë të qenësishme me pagjumësinë. Shala përcjell të njëjtën ndjesi në një intervistë për Kanal 10: “Fakti që nuk është bërë asgjë në lidhje me këtë çështje është diçka çnjerëzore. Nuk më zen gjumi kur mendoj se si nuk kanë bërë asgjë.”⁴² Si kundërpërgjigje ndaj kësaj heshtjeje e harrese të turpshme, Shala është shprehur në një sërë intervistash se: “E bëra unë. Dikush duhej ta bënte.”⁴³ Shpeshherë ai nyjëton ndijimin e barrës së turpit në emër të autorëve të krimeve që ka parë të kryhen, të atyre që duan të përfitojnë nga masakrat, si dhe në emër të qeverisë së Kosovës për incerinë e saj të pakuptueshme dhe harresën. Por, a i takon vërtet Shalës që ta mbajë këtë turp mbi shpatulla? Turpi, si ndjenjë shoqërore, është diçka që duhet mbajtur me çdo kusht, pra edhe nga dikush tjetër, nëse “pronarët” e vërtetë të tij refuzojnë ta mbajnë turpin mbi kurriz. Rrjedhimisht, nuk duhet të na habisë fakti se, në

Kosovë”, *Kallxo*, 17 gusht 2021.

⁴² “Esat Shala, grumbullues i dëshmimeve të krimeve të luftës së fundit në Kosovë – Kujdes pamje të rënda”, Kanal 10, 14 maj 2021.

⁴³ Po aty.

kontekste si ato të luftës e shtypjes, janë shpesh viktimat dhe jo autorët e krimeve, të cilët mbajnë mbi supe turpin që këta të fundit thjesht e refuzojnë.

Në përpjekjet e Shalës për t'iu kundërvënë kohësisë së të tjerëve dallojmë, gjithashtu, një gjest të një përkujdesjeje këmbëngulëse ndër-brezatare (*intergenerational*). Joan Tronto shkruan se përkujdesja përfaqëson një “veprimtari të qenies njerëzore, që përfshin gjithçka që ne bëjmë për të mirëmbajtur e siguruar vijimësinë e botës tonë, si dhe për ta ndrequr atë, në mënyrë që të jetojmë në të sa më mirë të jetë e mundur”.⁴⁴ Për Shalën, kjo nënkupton të jetosh me kokën lart, pa turpin e harresës. Praktika e tij përkujdesëse vazhdon të merret me të vdekurit dhe të zhdukurit, edhe pasi ata kanë rënë në harresë për këdo tjetër. “Gjaku” duket se është një element me rëndësi të veçantë për Shalën, një element të cilin ai e përshkruan si diçka që na lidh e na bashkon rreth detyrimeve që kemi brenda komunitetit tonë. Brezat që rrojnë pohojnë detyrimet (*munus*) që kanë ndaj brezave të mëparshëm dhe pritshmërinë që detyrimet e farefisit, të gjallë e të vdekur, do të shlyhen një ditë. Sipas zakoneve shqiptare, për shembull, gjaku i të vrarit ofendohet, pasi vrasësi copëton lidhjen e gjakut që viktimë ka me paraardhësit dhe pasardhësit e tij, çka e bën atë të kërkojë hakmarrje.⁴⁵

Kjo përkujdesje këmbëngulëse ndaj atyre që nuk jetojnë më kërkon, në një farë mënyre, që koha të pezullohet, ajo

⁴⁴ Joan Tronto, *Moral Boundaries: A Political Argument for an Ethic of Care*, Londër: Routledge, 1993, f. 103.

⁴⁵ Brunilda Pali dhe Robert E. Mackay, “Blood Feud Through the Historical Imagination of Ismail Kadare: An Analysis of *Broken April*”, *Oñati Socio-Legal Series* vëll. 11, nr. 6, 2021, f. 164-186.

kërkon një tjetër kohësi që ndryshon thelbësisht nga ajo e të tjerëve e që karakterizohet nga qëndrestaria dhe kokëfortësia.⁴⁶ Të jetuarit përmes kohës në këtë regjistër përfaqëson një eksperiencë kohore, që nuk është “as e mbushur me ngjarje (*eventful*) dhe as e gjallë (*vital*)”⁴⁷, dhe që të tjerëve mund t’u duket absurde. Poetja dhe filozofja Denise Riley i referohet kohësisë së kujdesit për të vdekurit si një “kohë e ndalur”, një çnyjzim i thellë i mënyrës sesi ata që kanë mbetur gjallë e përjetojnë kohën.⁴⁸ Kjo kohë e ndalur është njëherazi një kohë e mbushur me fantazma, një jetë e bashkëndarë me të ikurit, që kurrë nuk do të kthehen më, një kohë e zgjatur që i përkushtohet të vdekurve, kur ne i shërbejmë atyre.

Për Shalën, arkivimi i mizorive si një formë bashkëjetese me të vdekurit dhe si një mënyrë të jetuari në shërbim të tyre, përfaqëson “projektin” e jetës së tij (*lifework*). Ndonëse ky term përdoret më së shumti në lidhje me artin, mendojmë se përkufizimi i tij i përshtatet më së miri Shalës dhe projektit të tij arkivues. *Lifework* “mund të përkufizohet si art që përfshin nënshtrimin e një jete ndaj një praktike krijuese të projektuar, të pandërprerë dhe gjithëpërfshirëse, ku trupi i artistit dhe eksperiencia e tij jetësore marrin trajtat e një përmbajtjeje formësuese që është e pandashme nga vepra e artit”.⁴⁹ Për Shalën, arkivimi i masakrave është shndërruar në një praktikë gjithëpërfshirëse që vulozet njësoj në mendjen,

⁴⁶ Lisa Baraister, *Enduring Time*, Londër: Bloomsbury, 2017.

⁴⁷ Po aty, f. 13.

⁴⁸ Denise Riley, *Time Lived, without its Flow*, Londër: Capsule Edition, 2012, f. 49.

⁴⁹ Adrian Heathfield, “Thought of Duration”, në *Out of Now: The Lifeworks of Tehching Hsieh*, Cambridge, MA: MIT Press, 2009, f. 17-23 (f. 14).

zemrën dhe trupin e tij.

Ky durim dhe ngulmim, pamundësia për t'u ndalur e për t'u dorëzuar, kërkojnë, me kokëfortësi dhe disiplinë, ruajtjen e ndjenjës dhe horizontit të shpresës, ose, më mirë, të “dëshpërimit të pamposhtur”, një term që John Berger e përdor për të karakterizuar rezistencën në kontekstin e Palestinës.⁵⁰ Dëshpërimi i pamposhtur mund të kuptohet si beteja e vazhdueshme për t'i rezistuar dëshpërimit, kur etjen për drejtësi dhe ardhjen e saj i ndan një interval tepër i gjatë kohor.⁵¹

V. Përfundime

Shpresojmë që nëpërmjet këtij artikulli të kemi parashtruar disa reflektime mbi arkivin dhe raportin e tij me drejtësinë, kujtesën dhe kohën, duke u fokusuar në “projektin” arkivues të Esat Shalës në Kosovën e pasluftës. Ky projekt, që Shala ka më se njëzet vjet që e vazhdon me ngulm dhe kokëfortësi, ngre pyetje të rëndësishme mbi arkivin dhe luftën, që nuk mund t'i shkundim kollajshëm. Si mund të ndërtojmë një të ardhme për veten dhe komunitetet tona përballë mizorive të së kaluarës? Sa zgjat kujtesa? Po harresa, sa zgjat? Si mund të bashkëjetojmë me të vdekurit dhe të zhdukurit mes nesh? Cila është vlera e arkivit dhe kujt i takon përgjegjësia për të?

Ne e kemi lexuar “projektin” e Shalës për arkivimin e mizorive të së kaluarës si një formë këmbëngulëse të

⁵⁰ John Berger, “Dispatches: Undefeated Despair”, *Race & Class* vëll. 48, nr. 1, 2006, f. 23-41.

⁵¹ Lynne Segal, “Resisting Despair: A homage to Dr Eyad El-Sarraj”, https://www.academia.edu/10766214/Resisting_Despair?auto=download [referuar më 5 maj 2022].

dëshpërimin të pamposhtur dhe si një qëndrim thellësisht etik, si një sfidë përkundrejt harresës institucionale, dhe, gjithashtu, si një akt drejtësie e përkujdesjeje ndaj viktimave të luftës si dhe të të mbijetuarve të saj. Jemi përpjekur të argumentojmë se, ndonëse arkivi në vetvete nuk përbën një garanci të së vërtetës, drejtësisë ose kujtesës, dhe se arkivat në mbarë botën mbeten hapësira kontestimi, në mungesë të një *mal d'archive*, jemi, si të thuash, pa busull, dhe nuk kemi aftësinë as që ta kuptojmë të kaluarën e as që të pajtohemi me të, sado e dhimbshme apo traumatike.

Megjithatë, që arkivi i Shalës të shndërrohet në një instrument të vërtetë drejtësie, kujtese dhe kujdesi ndër-brezatar (*intergenerational*), projekti ka nevojë që të rimendohet përgjatë linjave se si ky arkiv mund të shndërrohet në një burim të përbashkët për brezat e tanishëm dhe ata që do të vijnë, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Shala duket i kapur midis dëshirës për të mbrojtur arkivin në mënyrë poseduese nga njëra anë, dhe dëshirës për t'ia dorëzuar atë Institutit Kërkimor për Krimet e Luftës, pasi ky të krijohet, nga ana tjetër. Rrjedhimisht, mbetet e paqartë nëse arkivi do të jetë ndonjëherë i arritshëm për të tjerët, në cilat kushte dhe për çfarë qëllimesh.